



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit, nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të shoqërisë ILIRIKA DZU AD Beograd nga shoqëritë nga shoqëritë e Grupit OTP.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.613 prot., i AK, datë 14.10.2022, “Përqendrimi ndërmjet OTP Group / ILIRIKA DZU AD, Beograd”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përftimin e kontrollit të shoqërisë ILIRIKA DZU a.d. Beograd nga shoqëritë OTP Alapkezelo Zartkouren Mukodo Reszvenytarsasag dhe OTP banka Srbija.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e aksioneve të ILIRIKA Drustvo za upravljanje UCITS fondom AD Beograd”, palët janë:

Blerësi 1: OTP Fund Management Pte.Ltd., është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit hungarez. OTP Fund Management është shoqëria lider e tregut për menaxhimin e fondeve të letrave me vlerë në Hungari. OTP Fund Management ka filiale në Rumani, Bullgari, Kroaci dhe Ukrainë.

Blerësi 2: OTP banka Srbija është një shoqëri aksionere, e regjistruar sipas legjislacionit serb, e fokusuar në risitë dhe dixhitalizmin e operacioneve të saj, duke u ofruar klientëve përfitime të reja në fokusin e digital banking, transferimin e fondeve tek individët private me e-mail dhe telefon etj. OTP Fund Management Pte.Ltd. dhe OTP banka Srbija janë pjesë e Grupit OTP.

Grupi OTP është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet filialit të tij OTP Bank Albania SHA.

Palët shitëse: ILIRIKA FINTRADE, financno posrednistvo, d.o.o, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve financiare dhe ato leasing; ILIRIKA svetovanje, poslovno svetovanje d.o.o, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve financiare dhe ILIRIKA borzno posredniska hisa d.d., Ljubljana, një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve financiare.

Target: ILIRIKA DZU AD Beograd është një shoqëri aksionare, pjesë e grupit të kompanive Ilirika, e angazhuar kryesisht si shoqëri brokerimi. Ilirika Group ofron shërbime të tregtimit të bursës, menaxhimit të instrumentave financiarë, shërbime nga fusha e shoqërive financiare dhe kryerjes së aktiviteteve të blerjes.

ILIRIKA DZU AD Beograd nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.